


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVË/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	01-1539/14
Dep.	02
Nr. i tag	
Broj stranica	
Nr. pages	
Date:	30.04.2014
Datum:	
Dati:	
PRINTED IN	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 28.04.2014, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I, Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-3285-13 për z.Nijazi Ademi – Anëtar i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike Postare (ARKEP), për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interes i në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3285-13, për Zyrtarin e lartë, z. Nijaz Ademi – Anëtar i Bordit të Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike Postare (ARKEP), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Nijazi Ademi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Ademi, është dekluaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Ademi, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-1472/14) në të cilën shihet është se është bërë shuarja vullnetare e biznesi privat, N.SH."Zhuri", duke parandaluar kështu konfliktin e interesit me funksionin e tij publik–Anëtar i Bordit në ARKEP.

III. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

